

**VENDIM**  
**Nr.771, datë 14.11.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË  
BASHKISË BURREL TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Burrel të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 482 (katërqind e tetëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Burrelit për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit     | Fusha e përdorimit të pronës                                                 | Lloji i transferimit |
|------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 14-20;22;23;26;27;28;                                | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative       | Në pronësi           |
| 34-49;                                               | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                      | Në pronësi           |
| 100-105;                                             | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.                      | Në pronësi           |
| 142;                                                 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.          | Në pronësi           |
| 143-151;185;186-379;384-389;415-427;428-452;453-482; | Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe ) dhe shërbime publike.      | Në pronësi           |
| 86-99;                                               | Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit.                          | Në pronësi           |
| 106;107;                                             | Varrezat publike.                                                            | Në pronësi           |
| 152-184;                                             | Infrastrukturë (troje)                                                       | Në përdorim          |
| 54;55;60-79;                                         | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik, dhe bujqësisë e ushqimit. | Në pronësi           |
| 111-122;383;                                         | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile                 | Në pronësi           |